


Qasja e Bazuar në Risk

FATF, më shumë se kurrë më parë, po i nxit qeveritë të kryejnë një Vlerësim Kombëtar të Riskut mbi pastrimin e parave (ML) dhe financimin e terrorizmit (TF). Ai u bën thirrje vendeve të 'identifikojnë, vlerësojnë dhe kuptojnë' rreziqet e ML/TF me të cilat përballen dhe të përcaktojnë 'një autoritet ose mekanizëm për të bashkërenduar veprimet dhe për të vlerësuar rreziqet'. Qëllimi i standartit është të sigurojë që vendet të mund të zbusin rreziqet ndaj ML/TF në mënyrë efektive, dhe vlerësimi i riskut qartësisht synon të shërbejë si bazë për zbatimin e qasjes së bazuar në risk, pra 'të sigurojë që masat...janë proporcionale me rreziqet e identifikuara '.

Një Qasje e Bazuar në Risk duhet të ketë këto parime:

- Të bazohet në fakte
- Të sigurojë përfshirjen e gjerë të sektorit të OJF-ve
- Të jetë proporcionale



Kjo fletëpalosje u përgatit në kuadër të projektit “Organizatat Jofitimprurëse në Shqipëri dhe Rekomandimi 8 i FATF”, i cili financohet nga Projekti Global i GIZ ‘Lufta kundër qarkullimit të paligjshëm të fondeve’.